



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 19

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8890, datë 2.5.2002	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian, në kuadër të Programit “Cards 2001””.....	593
Ligj nr.8891, datë 2.5.2002	Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit	602
Vendim i Kuvendit nr. 31, datë 2.5.2002	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.357, datë 9.9.1998 “Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr.399, datë 4.2.1999.....	609
Vendim i Kuvendit nr. 32, datë 2.5.2002	Për mosmiratimin e rezolutës mbi kërkesën për shkarkim të Drejtorit të SHISH-it.....	610
Vendim i Kuvendit nr. 33, datë 14.5.2002	Për emërimin e një anëtari të Komisionit të Letrave me Vlerë.....	610
Vendim i Kuvendit nr. 34, datë 14.5.2002	Për emërimin e një anëtari të Komisionit të Letrave me Vlerë.....	611
Vendim i Kuvendit nr. 35, datë 14.5.2002	Për caktimin e pagave të anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil.....	611
Dekret nr. 3332 datë 16.5.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	612

Dekret nr. 3339 datë 21.5.2002	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	613
Vendim i KM nr. 209, datë 16.5.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 602, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dhënies me koncesion të disa objekteve të industrisë së bakrit dhe të kromit”	613
Vendim i KM nr. 210, datë 16.5.2002	Për dhënie fond ndihme disa partive të reja politike.....	614
Vendim i KM nr. 211, datë 16.5.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr.508, datë 8.11.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dhënies me koncesion të Uzinës së Ferrokromit Elbasan dhe minierave të kromit Përrenjas dhe Pojskë”	614
Vendim i KM nr. 212, datë 16.5.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 38, datë 25.1.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dhënies me koncesion të “Superfosfatit” sh.a Kurbin”	615
Vendim i KM nr. 213, datë 16.5.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 82, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dhënies me koncesion të Minierës së Kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit, Burrel”	615
Vendim i KM nr. 219, datë 16.5.2002	Për mbrojtjen e racës autoktone të buajve nga zhdukja.....	616
Vendim i GjK nr. 91, datë 13.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	616
Vendim i GjK nr. 92, datë 13.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.70, datë 28.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	618
Vendim i GjK nr. 93, datë 13.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.2, datë 25.10.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe nr.160, datë 27.2.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	620
	<i>Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Artan Shefqet Xhukellari.....</i>	622
	<i>Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Kadrie Murat Hoxhaj</i>	622
	<i>Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzulla Buciza.....</i>	622
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Algjerim Halil Piliñçi.....</i>	622

LIGJ
Nr. 8890, datë 2.5.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETIT EUROPIAN, NË
KUADËR TË PROGRAMIT “CARDS 2001””**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian, në kuadër të Programit “CARDS 2001””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3341, datë 23.5.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE FINANCIARE

Nga njëra anë,
Qeveria e Shqipërisë, këtej e tutje referuar si “Përfituesi”, dhe
nga ana tjetër

Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar si “Komisioni”, duke vepruar për dhe në emër të Komunitetit Europian, këtej e tutje referuar si “Komuniteti”

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Masa referuar artikullit 1 më poshtë do të ekzekutohet dhe financohet nga Buxheti i Komunitetit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje. Kuadri teknik, ligjor dhe administrativ, brenda të cilit Masa, referuar artikullit 1 më poshtë do të zbatohet, është përcaktuar në kushtet e përgjithshme në aneksin A të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit dhe amenduar e plotësuar nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave të veçanta, bashkëngjitur kësaj.

Neni 1

Natyra dhe subjekti

Si një pjesë e programit të tij të ndihmës, Komuniteti do të kontribuojë, në formë granti, në drejtim të financimit të Masës së mëposhtme:

Titulli: Programi mbështetës për Shqipërinë në 2001

Vlera: Euro 37,5 milion

Datat e përfundimit: 31.12.2003 për kontraktim, 31.12.2004 për disbursim, me përjashtim të programit të taksave, për të cilin datat e përfundimit janë 31.12.2002 për kontraktim, 31.12.2003 për disbursim.

Neni 2
Angazhimi i Komunitetit

Kontributi financiar i Komunitetit është fiksuar në një maksimum prej euro 37,5 milion, këtej e tutje referuar si “Granti i KE-së”.

Granti i KE-së është subjekt i një afati mbarimi 31.12.2004. Komisioni mund, megjithatë, në varësi të rrethanave, të bjerë dakord për një zgjatje të përshtatshme të këtij afati skadence, në qoftë se një zgjatje e tillë kërkohet dhe justifikohet në mënyrë të saktë nga Përfituesi.

Neni 3
Adresat

Korrespondenca në lidhje me ekzekutimin e Masës, duke deklaruar numrin dhe titullin e Masës, do të adresohet si më poshtë:

Për Komisionin
Mr. Për Brix Knudsen
Komisioni i Komuniteteve Europiane
Zyra Europiane e Ndhmës dhe Bashkëpunimit
Rue de la Loi 200
B – 1049 Brussels, Belgium
Adresa telegrafike: COMEUR BRUXELLES
Telex: 21877 COMEU B
Fax: +32-2 296 74 82

Për Përfituesin
Z. Marko Bello
Ministër i Shtetit për Integrimin European
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4 256 267

Neni 4
Numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të jetë nënshkruar nga të dyja Palët. Çdo shpenzim që kryhet nga kjo datë i përmbush kushtet e Grantit të KE-së.

Anekset do të konsiderohen si në pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

ANEKSET:

Marrëveshje Kuadër

A. Kushtet e përgjithshme në lidhje me Marrëveshjet Financiare

B. Arbitrazhi

C. Përshkrimi i Masës

Deklaratë: Lidhur me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje financiare do të hyjë në fuqi në datën e ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar.

Vërtetohet se teksti në shqip i Marrëveshjes është i njëjtë me origjinalin.

ANEKSI A
KUSHTET E PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME MARRËVESHJET FINANCIARE

Në këto kushte të përgjithshme, termi “Marrësi” do të nënkuptohet se i referohet Qeverisë Shqiptare.

KREU I FINANCIMI I PROJEKTEVE

Neni 1 **Angazhimi i Komunitetit**

Angazhimi i Komunitetit, këtej e tutje referuar si “Granti i Ke-së”, vlera e të cilit është përcaktuar në Marrëveshjen financiare, do të vendosë kufirin brenda të cilit detyrimi dhe ekzekutimi i pagesave do të realizohet përmes kontratave dhe vlerësimeve të aprovuara në përputhje me rregullat.

Çdo shpenzim përtej Grantit të KE-së do të përballohet nga Përfituesi.

Neni 2 **Vlefshmëria e Grantit të KE-së**

Kur ekzekutimi i Masës varet nga detyrimet financiare nga burimet e veta të Përfituesit ose nga burime të tjera fondesh, Granti i KE-së do të bëhet i mundshëm në një kohë të tillë që detyrimet financiare të Përfituesit dhe/ose burimet e tjera të fondeve, siç janë përcaktuar në Marrëveshjen financiare, përmbushen.

Neni 3 **Disbursimi**

Kontratat janë të vlefshme për disbursime, sipas kësaj Marrëveshjeje financiare, vetëm në qoftë se janë konkluduar përpara afatit të skadencës të Marrëveshjes financiare. Disbursimet e këtyre kontratave mund të bëhen në një periudhë maksimum prej 12 muajsh pas afatit të skadencës së Marrëveshjes financiare.

KREU II DHËNIA E LEHTËSIRAVE

Neni 4 **Privilegjet e përgjithshme**

Personeli, pjesëmarrës në Masat e financuara nga Komuniteti, dhe anëtarët e familjes së tyre mund t’u akordohen përfitime, privilegje dhe përjashtime jo më pak të favorshme se atyre që u akordohen zakonisht të huajve të tjerë të punësuar në shtetin e Përfituesit, sipas çdo marrëveshjeje tjetër bilaterale ose multilaterale për asistencë ekonomike dhe programeve të bashkëpunimit teknik.

Neni 5 **Vendosja, instalimi, hyrja dhe lehtësirat e qëndrimit**

Në rast të kontratave të punimeve, furnizimit ose shërbimeve, personat fizikë ose juridikë, pjesëmarrës në procedurat e tenderimit, do t’u jepet e drejta që përkohësisht të vendosen dhe të qëndrojnë ku rëndësia e kontratës e kërkon një gjë të tillë. Kjo e drejtë do të jepet vetëm pasi ftesa për tender është publikuar dhe do të përfitohet nga stafi teknik me nevojën për të kryer studime përgatitore në hartimin e tenderave. Kjo e drejtë do të përfundojë një muaj pas përcaktimit të kontraktorit.

Përfituesi do të lejojë personelin pjesëmarrës në kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve, financiar nga Komuniteti, dhe anëtarët e familjes së tyre të hyjnë në shtetin e Marrësit të vendosen në këtë Shtet, të punojnë atje dhe të largohen nga Shteti në fjalë, në rast se natyra e kontratës e justifikon një gjë të tillë.

Neni 6

Importi dhe rieksporiti i pajisjeve

Përfituesi do të japë të gjitha lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të kërkuara për realizimin e Masës, subjekt i ligjeve, rregullave dhe rregulloreve ekzistuese të Përfituesit.

Përfituesi do t'i japë më tej personave fizikë dhe juridikë që kanë realizuar kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve, lejet e kërkuara për rieksporimin e pajisjeve në fjalë.

Neni 7

Importet dhe shkëmbimi i kontrollit

Për realizimin e Masës, Përfituesi merr përsipër të japë autorizime importi dhe autorizime për përfitimin e shkëmbimit valutor dhe të zbatojë rregullat e kontrollit të shkëmbimit valutor kombëtar pa diskriminim ndërmjet Shteteve Anëtare të Komunitetit dhe Shteteve përfituese sipas rregullores OBNOVA, Rregullores CARDS, vendet kandidate për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe, në rastin kur Komisioni ka autorizuar pjesëmarrjen në ftesat për tender dhe kontrata, vendet përfituese sipas programit TACIS dhe MEDA gjithashtu dhe vendet e tjera.

Përfituesi do të japë lejet e nevojshme të rikthejë fondet e marra në lidhje me Masën, në përputhje me rregulloret e kontrollit të shkëmbimit valutor në fuqi në shtetin e Përfituesit.

Neni 8

Taksat dhe doganat

1. Taksat, doganat dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Granti i KE-së.
2. Importet, sipas kontratave të furnizimit të konkluduara nga autoritetet e Përfituesit dhe financuar nga Granti i KE-së, do të lejohen të hyjnë në shtetin e Përfituesit pa qenë subjekt i detyrimeve doganore, detyrimeve të importit, taksave ose tarifave fiskale që kanë efekt të njëjtë.
3. Përfituesi do të sigurojë që importet në fjalë do të lejohen nga pika e hyrjes për t'u shpërndarë tek kontraktorët, siç kërkohet nga dispozitat e kontratës dhe për përdorim të menjëhershëm, siç kërkohet për një zbatim normal të kontratës, pavarësisht nga ndonjë vonesë ose konflikt mbi zgjidhjen e detyrimeve të përmendura më sipër, taksave ose tarifave.
4. Kontratat për furnizime ose shërbime të zbatuara nga firmat shqiptare ose të huaja, të financuara nga Granti i KE-së nuk do të jenë subjekt në shtetin e Përfituesit, të taksës mbi vlerën e shtuar, vulës dokumentuese, detyrimeve të regjistrimit ose tarifave fiskale që kanë efekt të njëjtë, pavarësisht nëse tarifa të tilla ekzistojnë apo që do të institucionalizohen.
5. Personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë stafin e huaj, nga Vendet Anëtare të Komunitetit Europian, që realizojnë kontratat e bashkëpunimit teknik financiar nga Granti i KE-së, do të përjashtohen nga taksa e aktivitetit dhe të ardhurave në Shtetin e Përfituesit.
6. Mallrat personale dhe të familjes të importuara për përdorim personal nga personat fizikë (dhe anëtarët e familjeve të tyre), përveç atyre të marra brenda vendit, të përfshirë në realizimin e detyrave të përcaktuara në kontratat e bashkëpunimit teknik, do të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit, taksave dhe tarifave të tjera fiskale që kanë efekt të njëjtë mallrat personale dhe të familjes në fjalë do të rieksporohen ose do të lihen në vend, në përputhje me rregulloret në fuqi në shtetin e Përfituesit pas përfundimit të kontratës.
7. Personat fizikë dhe juridikë që importojnë pajisje profesionale, siç është parashikuar në artikullin 9, në qoftë se ata e kërkojnë një gjë të tillë, do të përfitojnë nga sistemi i pranimit të përkohshëm, siç përcaktohet nga legjislacioni kombëtar i Përfituesit në lidhje me pajisjet në fjalë.

KREU III REALIZIMI I KONTRATAVE

Neni 9 **Origjina e furnizimeve**

Përfituesi bie dakord që, përveçse kur autorizohet ndryshe nga Komisioni, materialet dhe pajisjet e kërkuara për realizimin e kontratave duhet ta kenë origjinën në Komunitet, në Shtete Përfituese sipas Rregullores OBNOVA, Rregullores CARDS, vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe, në rastin kur Komisioni ka autorizuar pjesëmarrjen në ftesat për tender dhe kontrata, vendet përfituese sipas programit TACIS dhe MEDA gjithashtu dhe vendet e tjera.

Neni 10 **Procedurat e pagesës**

1. Për kontratat e financuara nga Granti i KE-së, tenderat do të hartohen dhe pagesat do të bëhen ose në euro ose, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e këmbimit valutor të Përfituesit, në monedhën e Përfituesit, ose në monedhën e Shtetit ku tenderuesi ka të regjistruar vendin e tij të biznesit, ose në monedhën e Shtetit ku materialet janë prodhuar.

2. Kur tenderat janë bërë në euro, pagesat në lidhje me to do të bëhen siç duhet, në monedhën e përcaktuar në kontratë, mbi bazën e vlerës ekuivalente të euros në ditën e procedimit të pagesës.

KREU IV BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMISIONIT DHE PËRFITUESIT

Neni 11 **Inspektimi dhe kontrolli**

1. Komisioni, duke përfshirë dhe Zyrën Europiane Anti-Evazion (OLAF), do të ketë të drejtën për të dërguar agjentët e saj ose përfaqësues të autorizuar për të realizuar çdo mision apo kontroll teknik dhe financiar që ai e konsideron të nevojshme për të ndjekur realizimin e Masës. Megjithatë, Komisioni do t'i japë autoriteteve të Përfituesit një lajmërim paraprak për misione të tilla.

Përfituesi do të japë të gjithë informacionin dhe dokumentet, të cilat do të kërkohen prej tij dhe do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të lehtësuar punën e personave të instruktuar për të realizuar kontrollin apo inspektimin.

2. Përfituesi:

(a) do të mirëmbajë të dhënat dhe llogaritë adekuate për të identifikuar punimet, furnizimet ose shërbimet e financuara sipas Marrëveshjes financiare, në përputhje me procedurat bazë të kontabilitetit;

(b) do të sigurojë që agjentët e lartpërmendur ose përfaqësues të Komisionit kanë të drejtën për të inspektuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe llogaritë që i përkasin pikave të financuara sipas Marrëveshjes financiare dhe të ndihmojë Gjykatën e Auditimit të Bashkimit Europian për të realizuar kontrollin në lidhje me përdorimin e Grantit të KE-së.

Komisioni mund të realizojë gjithashtu një vlerësim ex - post dhe një kontroll përfundimtar të programit. Vlerësimi ex-post do të vlerësojë arritjet e objektivave/qëllimeve të programeve, gjithashtu dhe impaktin mbi zhvillimin dhe ristrukturimin e sektorit në fjalë.

Kontrolli përfundimtar do të rishikojë të dhënat financiare lokale të programit, duke dhënë një opinion të pavarur mbi saktësinë dhe përputhjen e kontratave dhe disbursimeve, gjithashtu dhe përputhshmëria e saj me dispozitat e Marrëveshjes financiare.

KREU V
DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 12
Delegimi i zbatimit

Në zbatim të artikullit 4 të Marrëveshjes Kuadër, delegimi i përgjegjësive të zbatimit tek një Palë e tretë mund të bihet dakord përmes një shkëmbimi letrash ndërmjet Përfituesit dhe Komisionit Europian.

KREU VI
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Konsultimet, mosmarrëveshjet

1. Çdo çështje në lidhje me realizimin ose interpretimin e Marrëveshjes financiare ose të Kushteve të Përgjithshme, do të jetë subjekt i konsultimeve ndërmjet Përfituesit dhe Komisionit, duke çuar, kur është e nevojshme, në një amendament të Marrëveshjes financiare.

2. Në rast të mospërbushjes së detyrimit të përcaktuar në Marrëveshjen financiare dhe në Kushtet e Përgjithshme, e cila nuk ka qenë subjekt i masave rregulluese të marra në kohën e duhur, Komisioni mund të pezullojë financimin e Masës, pas konsultimeve me Përfituesin.

Përfituesi mund të mos pranojë në tërësi ose pjesërisht realizimin e Masës. Palët Kontraktuese do të përcaktojnë detajet e mospranimit në fjalë në një shkëmbim letrash.

Neni 14
Lajmërimi, adresat

Çdo lajmërim dhe çdo marrëveshje ndërmjet Palëve, të bërë për këtë qëllim, duhet të jetë subjekt i një komunikimi me shkrim duke iu referuar në mënyrë eksplicite numrit dhe titullit të Masës. Të tilla lajmërimet ose marrëveshjet do të bëhen me letra të dërguara tek Pala e autorizuar për të marrë të njëjtën dhe e dërguar në adresën e lajmëruar nga Pala në fjalë. Në rast urgjence, komunikimi me telefaks, telegraf ose teleks do të lejohet dhe do të gjykohet i vlefshëm, me kusht që të konfirmohen menjëherë me letër.

Adresat janë të përcaktuara në Marrëveshjen financiare.

ANEKSI B
ARBITRAZHI

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, që del nga Marrëveshja Kuadër ose Marrëveshja financiare, e cila nuk është zgjidhur duke zbatuar procedurat e përcaktuara në artikullin 12 të kushteve të përgjithshme në lidhje me Marrëveshjen financiare, do të shqyrtohet në arbitrazh nga një Tribunal, siç përcaktohet këtu poshtë.

Palë në një arbitrazh të tillë do të jetë Përfituesi nga njëra anë dhe Komisioni nga ana tjetër.

Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra, të emëruar si më poshtë:

- Një arbitër të emëruar nga Përfituesi;

- Një arbitër i dytë do të emërohet nga Komisioni.

- Arbitri i tretë (këtëj e tutje ndonjëherë do të thirret "Arbitri") do të emërohet me marrëveshje të Palëve ose, në qoftë se ato nuk bien dakord, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në qoftë se asnjëra nga Palët nuk arrin të emërojë një arbitër, Arbitri do të emërojë arbitra të tillë.

Në qoftë se ndonjë nga Arbitrat e emëruar në përputhje me këtë dispozitë heq dorë, vdes ose bëhet i paaftë për të vepruar, një tjetër Arbitër do të emërohet në të njëjtën mënyrë si Arbitri vendin e të cilit ai mori; pasardhësi i tillë do të ketë të gjitha pushtetet dhe detyrimet e Arbitrit të zëvendësuar.

ANEKSI C PËRSHKRIMI I MASAVE

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Qëllimi i asistencës është të mbështesë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Procesin e Stabilizimit dhe Asocimit (SAP).

Objektivat kryesorë specifikë të kësaj asistence janë: kontributi për të rritur kapacitetin e Shqipërisë në aspektin e sigurisë dhe rendit publik, forcimit të rregullit të ligjit, qeverisje e mirë dhe respekti për të drejtat e njeriut, krijimi i kushteve të përshtatshme për bashkëpunim rajonal, forcimi i financave publike, rritja e të ardhurave nga doganat dhe taksat, forcimi i standardeve dhe certifikimit, forcimi i koordinimit të ndihmës, përmirësimi i zhvillimit të komunitetit lokal dhe rritja e kualitetit të arsimit të lartë.

AKTIVITETET

1. Drejtësia dhe çështjet e brendshme

1.1. Policia dhe rendi publik

Krijimi i një misioni asistence për policinë të KE-së në Shqipëri (ECPAM-A) dhe rehabilitimi i stacioneve të policisë.

1.2. Menaxhimi i integruar i kufijve

Asistencë teknike për të zhvilluar një strategji menaxhimi të integruar të kufijve dhe të përgatisë një plan veprimi specifik për përmirësimin e kontrollit të kufijve detarë të Shqipërisë.

1.3. Sistemi gjyqësor; burgjet

Ndërtimi i Burgut të Fushë-Krujës dhe krijimi i një plani për të paraburgosurit.

1.4. Azili dhe menaxhimi i migrimit

Trainime për Ministrinë e Rendit Publik dhe agjencitë vartëse dhe rinovimi apo rindërtimi i një ose më shumë qendra pritjesh.

2. Ndërtimi i institucioneve

2.1. Doganat

Vazhdimësia e asistencës së dhënë për administratën doganore në Shqipëri nga Misioni i Asistencës Doganore në Shqipëri (CAM-A).

2.2. Financat publike

2.2.1. Taksat

Asistenca për autoritetet shqiptare për të zhvilluar një strategji të integruar të teknologjisë së informacionit (IT) për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duke mbuluar taksat direkte dhe indirekte.

2.2.2. Kontrolli i brendshëm i financave publike

Forcimi i kapacitetit të Departamentit të Kontrollit Financiar për të krijuar standarde të larta të kontrollit të brendshëm të financave publike.

2.3. Standardet dhe certifikimi

Mbështetje për ndërtimin e institucioneve/harmonizim legjislativ/ zbatimimi në fushën e standardeve dhe certifikimit.

2.4. Koordinimi i ndihmës

Këshillë dhe trajnim mbi programimin e ndihmës dhe koordinimin.

2.5. Operim në shkallë të vogël

Ky element operimi në shkallë të vogël (SSO) është një mekanizëm i një veprimi të shpejtë për t'i adresuar në mënyrë të menjëhershme fondet e vlefshme të justifikuara të kërkuara në nivel lokal nga OJQ-të, strukturat rajonale dhe lokale, institucionet publike ose gjysëm-publike, partnerët socialë, grupet e grave, media e pavarur, grupet kulturore, organizata që mbështesin biznesin, shoqatat dhe fondacionet.

3. Zhvillimi ekonomik, zhvillimi komunitetit lokal

Vazhdimësia e katër programeve të mëparshme të KE-së, zbatuar përmes fondit Shqiptar të Zhvillimit

4. Tempus

Financimi për projektet e përbashkëta europiane (JEP) dhe grantet e lëvizshme individuale në fushën e arsimit të lartë.

BUXHETI

SEKTORI I:

Drejtesia dhe çështjet e brendshme	€ 16.0 m
Policia & rendi publik	€ 10.0 m
Menaxhimi i integruar i kufijve	€ 1.5 m
Sistemi gjyqësor; burgjet	€ 3.5 m
Azili & menaxhimi i migrimit	€ 1.0 m

SEKTORI II:

Ndërtimi i institucioneve	€ 9.0 m
Doganat	€ 2.0 m
Financat publike	
- Taksat	€ 2.0 m
Kontrolli i brendshëm i financave publike	€ 2.3 m
Standardet & certifikimit	€ 2.0 m
Koordinimi i ndihmës	€ 0.5 m
Veprime në shkallë të vogël	€ 0.2 m

SEKTORI III:

Zhvillimi ekonomik	€ 10.0 m
Zhvillimi i komunitetit lokal	

SEKTORI IV:

Arsimi	€ 2.5 m
Tempus	

TOTALI: € 37.5 m

ZBATIMI

Programi do të zbatohet nga shërbimet e komisionit në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse kombëtare dhe/ose lokale.

Kontratat për shërbimet, punimet dhe furnizimet do të konkludohen, në përputhje me procedurat e tenderimit dhe kontratave përcaktuar në Rregulloren Financiare, Rregulloren e Këshillit 2666/2000 dhe "Manuali i instruksioneve për kontratat e konkluduara për qëllim të bashkëpunimit të Komunitetit me vendet e treta" (adaptuar prej Komisionit në 10 nëntor 1999).

MONITORIMI, VLERËSIMI DHE KONTROLLI

Ky program do të monitorohet dhe supervizohet nga Shërbimet e Komisionit Europian, që:

a) do të monitorojë zbatimin e programit mbi bazën e raporteve të rregullta, kontakteve me sipërmarrësit dhe vizitat në terren;

b) do të realizojë monitorim dhe vlerësim të rregullt për të ndjekur progresin e programit dhe komponentët e tij, si dhe vlerësimin e ex-post pas përfundimit të tij.

Llogaritë dhe veprimet e komponentëve të programit do të kontrollohen me intervale nga një kontrollues i jashtëm i kontraktuar nga Komisioni, pa paragjykuar përgjegjësitë e Komisionit Europian, duke përfshirë Zyrën Europiane Antievazion European (OLAF) dhe Gjykatën e Auditimit të Bashkimit Europian.

LIGJ

Nr. 8891, datë 2.5.2002

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE HETIMORE TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 77 pika 3, 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisioneve hetimore të Kuvendit, sipas parimeve të parashikuara në nenin 77 të Kushtetutës.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

1. “Komision” do të thotë komision hetimor i Kuvendit, i ngritur sipas rregullave të këtij ligji.

2. “Dëshmitar” është personi i thirrur nga komisioni për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet që ai/ajo di, në lidhje me çështjen objekt hetimi.

3. “Hetime” janë veprimet procedurale që ndërmerren nga komisioni për të sqaruar një çështje të veçantë, por pa marrë të pandehur dhe pa ngritur akuzë penale.

4. “Provë” është çdo e dhënë, dëshmi, dokument apo fakt që shërben në nxjerrjen e konkluzioneve të hetimit dhe që merret sipas rregullave të këtij ligji.

5. “Ekspertët” janë persona që për shkak të njohurive profesionale thirren nga komisionet për të bërë akte ekspertimi mbi ngjarje apo dokumente që lidhen me hetimin. Statusi i tyre është i njëjtë me atë të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

6. “Ekspert ligjor” është personi me njohuri në fushën e hetimit, i cili emërohet pranë Kuvendit dhe vihet në dispozicion të komisionit.

7. “Vendim i ndërmjetëm” është vendimi i komisionit i marrë, sipas këtij ligji, në çdo fazë të hetimit për ndërmarrjen e procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, thirrjes së ekspertëve, kërkimit të informacionit dhe të dokumenteve zyrtare dhe që nuk përmban asnjë konkluzion përfundimtar.

8. “Vendim përfundimtar” është vendimi që merret nga komisioni, i cili përmban pjesën konstatuese dhe konkluzionet e hetimit.

9. “Zyrtarë me imunitet” konsiderohen zyrtarët që gëzojnë imunitet nga ndjekja penale.

10. “Mendim i pakicës” është mendimi ndryshe në lidhje me rekomandimet përfundimtare të komisionit, i anëtarëve që mbeten në pakicë në komision, i cili shoqëron vendimin përfundimtar dhe që i paraqitet Kuvendit për shqyrtim e miratim.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë së komisioneve hetimore të Kuvendit

1. Komisionet hetimore të Kuvendit krijohen për të hetuar çështje të veçanta, sipas nenit 77 pika 2 të Kushtetutës.

2. Komisioni hetimor i Kuvendit krijohet edhe për të hetuar mbi zyrtarë me imunitet që kanë lidhje me çështjen që është objekt i hetimit.

3. Kuvendi ka të drejtë të caktojë komision hetimor sa herë që fillon procedurën e shkarkimit të zyrtarëve të lartë, të parashikuar në nenet 62, 73 pika 3, 90 pika 2, 128, 140, 149 pika 2 dhe 162 të Kushtetutës, si dhe në rastet kur ligji i jep të drejtë Kuvendit të shkarkojë zyrtarë të tjerë.

4. Komisioni nuk mund të ngrejë akuza penale dhe as të ushtrojë atributet e gjykatave.

Neni 4

Parime të përgjithshme

1. Komisionet hetimore të Kuvendit ngrihen dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

2. Rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për hetimin zbatohen drejtpërdrejt nga komisionet hetimore të Kuvendit, për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

3. Vendimi përfundimtar i komisionit hetimor të Kuvendit shoqërohet gjithmonë me mendimin e pakicës dhe shpallet publikisht.

4. Komisionet organizohen dhe funksionojnë, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

5. Komisionet hetimore të Kuvendit paraqesin rekomandime në seancë plenare dhe, kur këto miratohen, i dërgohen Prokurorit të Përgjithshëm për marrjen e masave të mëtejshme.

6. Komisionet hetimore nuk mund të ngrihen gjatë 4 muajve para mbarimit të mandatit të Kuvendit.

7. Prokurori i Përgjithshëm informon Kuvendin për ecurinë e hetimit mbi çështjet e rekomanduara për hetim.

KREU II

PROCEDURAT E KRIJIMIT TË KOMISIONEVE HETIMORE TË KUVENDIT

Neni 5

Nisma për krijimin e komisionit

1. Komisioni krijohet me kërkesë të 35 deputetëve.

Grupi nismëtar paraqet qëllimin e krijimit të komisionit, çështjen që do të hetohet, propozimin për përbërjen e komisionit dhe afatin e përafërt të përfundimit të hetimeve. Kuvendi është i detyruar ta miratojë ngritjen e komisionit.

2. Kuvendi ka të drejtë të krijojë komision hetimi, sipas rregullave të këtij ligji, kur kërkohet nga jo më pak se 5 deputetë, ose nga një komision i përhershëm, për hetimin e një çështjeje të veçantë, ose kur fillon procedura e shkarkimit të zyrtarëve me imunitet.

Neni 6

Forma për ushtrimin e nismës

Nismëtarët e ngritjes së komisionit duhet t'i paraqesin kërkesë me shkrim Kryetarit të Kuvendit, e cila përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 5, si dhe nëshkrimet e grupit nismëtar.

Neni 7

Detyrimet e Kryetarit të Kuvendit

1. Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së kërkesës, mbledh Byronë e Kuvendit për të diskutuar mbi kërkesën e nismëtarëve, përbërjen e komisionit dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend.

2. Kur Byroja e Kuvendit nuk arrin të përcaktojë elementet e mësipërme me konsensus, atëherë këto çështje i adresohen seancës plenare, e cila vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

3. Kërkesa paraqitet për miratim në seancën plenare më të afërt, por jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes së Byrosë të Kuvendit.

4. Brenda 7 ditëve nga miratimi i vendimit, komisioni fillon punën.

5. Kryetari i Kuvendit, menjëherë pas marrjes së vendimit për ngritjen e komisionit, cakton mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm. Në çdo rast komisionit i vihet në dispozicion eksperti jurist.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit merr masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit.

Neni 8

Detyrimet e Kuvendit

1. Kuvendi miraton ngritjen dhe përbërjen e komisionit të kërkuar, sipas nenit 5 të këtij ligji, me shumicën e thjeshtë të deputetëve të pranishëm.

2. Vendimi i Kuvendit duhet të përmbajë qëllimin e krijimit të komisionit, objektin e hetimit, numrin dhe anëtarët e tij, sipas përkatësisë politike, si dhe kryetarin e zëvendëskryetarin.

3. Kuvendi nuk mund të vendosë kufizime në objektin e punës, përbërjen dhe kohëzgjatjen e komisionit të kërkuar nga grupi i deputetëve nismëtarë, përveç rasteve kur nga rrethanat gjykohet se kërkesa përmban elemente të shkeljes së Kushtetutës.

KREU III

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONEVE HETIMORE TË KUVENDIT

Neni 9

Përbërja e komisionit

1. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 9 dhe jo më shumë se 15 deputetë, por gjithmonë me numër tek.

2. Komisioni përbëhet nga deputetë të partive të pozitës dhe të opozitës, në raporte sa më të afërta përfaqësimi, por diferenca të jetë jo më shumë se një anëtar.

3. Kryetari i komisionit i takon atij grupimi politik, deputetët e të cilit janë nismëtarë të krijimit të komisionit. Në këtë rast zëvendëskryetari i takon grupimit tjetër.

4. Emrat e deputetëve anëtarë të komisionit, raportet e përfaqësimit në komision, si dhe përkatësia politike e vendit të kryetarit dhe zëvendëskryetarit diskutohen në Byronë e Kuvendit, të cilat i propozohen Kuvendit për miratim.

5. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të tërhiqen nga komisioni në çdo kohë që ata e çmojnë të arsyeshme, me përjashtim të momentit kur komisioni do të marrë vendimin përfundimtar.

6. Anëtarët e larguar zëvendësohen nga grupimi politik që ato përfaqësojnë, jo më vonë se 3 ditë nga data e deklarimit të tërheqjes së tyre. Anëtari i ri miratohet në seancën plenare më të parë të Kuvendit, me propozim të grupimit politik përkatës.

7. Në rastet e mungesave të anëtarit të komisionit të hetimit, pa shkaqe të përligjura në më shumë se 3 mbledhje radhazi, komisioni vendos që të kërkojë zëvendësimin e tij në seancën plenare më të afërt të Kuvendit. Anëtari i ri ka të drejtë të njihet me përmbajtjen e të gjithë veprimtarisë së zhvilluar nga ana e komisionit.

8. Kur një grupim politik tërheq anëtarët e tij nga komisioni, atëherë Kuvendi i zëvendëson ata me deputetë të tjerë. Në rast se anëtarët e tërhequr të komisionit i takojnë grupimit politik ku bëjnë pjesë nismëtarët e komisionit, Kuvendi vendos pushimin e veprimtarisë së mëtejshme të komisionit.

Kur largohet kryetari ose zëvendëskryetari, atëherë komisioni zgjedh një të ri pasi vendi i mbetur bosh plotësohet sipas procedurës së mësipërme.

Neni 10

Drejtimi i komisionit

1. Kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit drejtojnë të gjithë veprimtarinë e tij në përputhje me këtë ligj, si dhe me Rregulloren e Kuvendit. Në mungesë të kryetarit, detyrat e tij kryhen nga zëvendëskryetari.

2. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh nga radhët e tij, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, një sekretar, i cili drejton çështjet administrative dhe teknike.

Neni 11

Thirrja e komisionit

1. Mbledhja e parë e komisionit thirret nga kryetari dhe zëvendëskryetari i tij jo më vonë se tri ditë nga data e marrjes së vendimit për krijimin e komisionit.

2. Kryetari njofton të gjithë anëtarët e komisionit për datën, orën dhe vendin e mbledhjes.

3. Në mbledhjen e parë marrin pjesë anëtarët e komisionit dhe personeli i caktuar në shërbim të komisionit.

4. Kryetari deklaron qëllimin e ngritjes së komisionit, përcakton detyrat e komisionit, si dhe planin paraprak të hetimit.

Neni 12

Zhvillimi i mbledhjeve

1. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga kryetari dhe/ose me autorizimin e tij nga zëvendëskryetari i komisionit. Prania e personave të tjerë në mbledhjet e komisionit vendoset nga komisioni me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

2. Anëtarët e komisionit shprehin lirisht mendimin e tyre dhe votojnë sipas bindjes së tyre. Në asnjë rast nuk lejohet që të fyejnë ose të prekin dinjitetin personal të personave të thirrur në komision.

3. Mbledhjet e komisionit janë si rregull të hapura, me përjashtim të rasteve kur komisioni vendos ndryshe.

4. Çdo mbledhje e komisionit si rregull incizohet dhe në çdo rast mbahet procesverbal i mbledhjes, në të cilin regjistrohet gjithçka thuhet në të.

5. Kryetari dhe/ose sekretari në fund të çdo mbledhjeje firmosin procesverbalin.

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

2. Komisioni merr vendime të ndërmjetme me shumicën e anëtarëve të pranishëm, ndërsa vendimet përfundimtare merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

3. Komisioni voton zakonisht me ngritjen e dorës, përveç rastit kur me kërkesën e të paktën tre anëtarëve kërkohet që votimi të bëhet nominal ose i fshehtë.

4. Kërkesa për hetime ose marrje provash nga çdo anëtar i komisionit pranohet nga komisioni pa votim.

Neni 14

Kompetencat e komisionit

Në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç detyrave të parashikuara në këtë ligj, komisioni ka këto drejta dhe kryen këto detyra:

- a) kryen hetime, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;
- b) thërret titullarë institucionesh për pyetje, si dhe kërkon nga ata informacione ose dokumente zyrtare;
- c) merr në pyetje dëshmitarë dhe persona të tjerë;
- ç) merr vendime, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj;
- d) përgatit dhe miraton vendimin përfundimtar të hetimit, së bashku me mendimin e pakicës;
- dh) paraqet për miratim në Kuvend raportin përfundimtar.

KREU IV

KRYERJA E HETIMEVE

Neni 15

Fillimi i hetimit

1. Pas njohjes me objektin e çështjes që do të hetohet, komisioni mbledh të dhëna për çështjen. Të dhënat mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, por që njihen publikisht.

2. Komisioni merr të dhëna nga burime të drejtpërdrejta.

3. Pasi sigurohen të dhënat paraprake për çështjen, komisioni me vendim të ndërmjetëm miraton planin e hetimeve deri në përfundimin e tyre. Plani i hetimeve mund të ndryshojë gjatë zhvillimit të hetimeve, kur dalin prova ose ngjarje të reja që lidhen me çështjen.

4. Plani i hetimeve përmban gjithë hapat proceduralë, veprimet hetimore që do të ndiqen nga komisioni për hetimin e çështjes, si dhe rrethin e personave që do të merren si dëshmitarë ose ekspertë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

5. Pas miratimit të planit të hetimit, komisioni deklaron fillimin e hetimeve.

Neni 16
Thirrja për të dëshmuar

1. Komisioni thërret dëshmitarë për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
2. Thirrja e dëshmitarëve bëhet me vendim të ndërmjetëm.
3. Të gjitha dëshmitë e marra regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes të komisionit.
4. Kur dëshmitari nuk paraqitet pa arsye të përligjura, i kërkohet organeve të policisë të bëjnë thirrjen me forcë të tij.

Neni 17
Administrimi i dokumenteve dhe të dhënave të tjera që ndihmojnë hetimet

1. Në shërbim të hetimeve mbi çështjen, komisioni administron dokumente zyrtare, si dhe të dhëna të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e hetimeve.
2. Organet kompetente që i disponojnë këto të dhëna dhe dokumente janë të detyruara t'ia përcjellin zyrtarisht komisionit, sipas kërkesës së tij.
3. Anëtarët dhe personeli ndihmës i komisionit janë përgjegjës për ruajtjen e sekretit shtetëror gjatë hetimeve, sipas rregullave të parashikuara në nenet 159,160 dhe 161 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 18
Ekspertët

1. Ekspertët thirren dhe kanë detyrime, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
2. Për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen, komisioni thërret ekspertë të njohur nga gjykata për fusha të ndryshme.
3. Ekspertët janë të detyruar të raportojnë me shkrim për pyetjet që ngre komisioni për ta.
4. Ekspertët duhet të jenë të paanshëm në konkluzionet e tyre dhe duhet të raportojnë mendimin e tyre për çështjen mbi parimet e profesionalizmit.

Neni 19
Përfundimi i hetimit

1. Hetimet quhen të përfunduara kur përmbushen të gjitha pikat e planit të hetimeve dhe kur komisioni krijon mendim të qartë për çështjen objekt hetimi.
2. Përfundimi i hetimeve deklarohet me vendim të ndërmjetëm.

Neni 20
Përgatitja e raportit përfundimtar

1. Pas përfundimit të hetimeve, kryetari i komisionit paraqet raportin përfundimtar të hetimeve, i cili përmban konkluzionet e hetimit, provat që kanë çuar komisionin në këto konkluzione, si dhe propozime për zgjidhjen e çështjes ose masa ndëshkimore për persona përgjegjës, kur ka të tillë.
2. Raporti përfundimtar shoqërohet edhe me planin e hetimeve, si dhe me aktet e ekspertimit, që mund të jenë bërë gjatë hetimit.
3. Kur komisioni, pas përfundimit të hetimeve, çmon se zyrtarë me imunitet plotësojnë kushtet për shkarkimin e tyre, propozon fillimin e procedurave të shkarkimit.

Kur këto procedura kanë filluar, i mbështet ato me konkluzionet e hetimit.
4. Raporti përfundimtar miratohet nga komisioni me vendim përfundimtar.

Neni 21
Mendimi i pakicës

Anëtarët e komisionit që kanë mendim ndryshe, pjesërisht ose të plotë, me konkluzionet e raportit përfundimtar, duhet të përgatisin me shkrim mendimet e tyre, që i bashkëngjiten vendimit përfundimtar.

Neni 22
Paraqitja e raportit në Kuvend

1. Raporti përfundimtar i paraqitet seancës plenare të Kuvendit brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të komisionit.
2. Kuvendi i miraton konkluzionet e komisionit në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 78 të Kushtetutës.
3. Kur raporti i miratuar në Kuvend përmban të dhëna për ekzistencën e veprave penale, atëherë ai i dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale.
4. Prokurori i Përgjithshëm, kur konstaton se janë kryer vepra penale, fillon çështjen penale dhe më pas njofton Kuvendin për fillimin e hetimeve.
5. Kur raporti i Kuvendit përmban të dhëna për vepra penale të kryera nga një zyrtar me imunitet dhe Kuvendi nuk e ka shkarkuar atë, atëherë Prokurori i Përgjithshëm i kërkon Kuvendit heqjen e imunitetit të zyrtarit përkatës.
6. Me paraqitjen e raportit përfundimtar në Kuvend, komisioni pushon së ekzistuari.

Neni 23
Buxheti i komisionit

1. Për veprimtarinë e tij, komisioni ka fondin financiar të caktuar nga Kuvendi me propozim të komisionit.
2. Shpenzimet e komisionit miratohen dhe ndiqen nga kryesia e komisionit. Anëtarët e komisionit shpërblehen në bazë të rregullave të caktuara në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 24
Dispozitë e fundit

1. Komisioni hetimor i Kuvendit për organizimin e mbledhjeve mbështetet në Rregulloren e Kuvendit.
2. Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së tij, komisioni hetimor i Kuvendit harton dhe miraton rregulloren e brendshme.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3342, datë 23.5.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

VENDIM
Nr. 31, datë 2.5.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.357, DATË 9.9.1998
“RREGULLORJA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR.399, DATË 4.2.1999

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 88 e 173 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore, Komisionit të Përhershëm të Imunitetit, Mandateve dhe Rregullores dhe Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në vendimin e Kuvendit nr.357, datë 9.9.1998 “Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr.399, datë 4.2.1999, neni 11 pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, miraton Rregulloren e Brendshme, numrin e punonjësve, strukturën organizative, emërtesat dhe nivelin e pagave, shpërblimeve dhe dietave ditore, në përputhje me tabelën e pagave të administratës publike të nivelit qendror”.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 32, datë 2.5.2002

PËR MOSMIRATIMIN E REZOLUTËS MBI KËRKESËN
PËR SHKARKIM TË DREJTORIT TË SHISH-IT

Në mbështetje të neneve 88, 92 e 157 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e rezolutës së paraqitur nga një grup deputetësh të opozitës për t'i kërkuar Kryeministrit, zotit Pandeli Majko, që të propozojë shkarkimin e Drejtorit të SHISH-it, zotit Fatos Klosi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 33, datë 14.5.2002

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 3 pika 3 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8168, datë 5.12.1996 dhe ligjin nr.8745, datë 22.2.2001, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Manjola Naço emërohet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 34, datë 14.5.2002

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË LETRAVE ME VLERË

Në mbështetje të nenit 3 pika 3 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8168, datë 5.12.1996 dhe ligjin nr.8745, datë 22.2.2001, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Keler Gjika emërohet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Letrave me Vlerë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 35, datë 14.5.2002

PËR CAKTIMIN E PAGAVE TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 5 pika 9 dhe 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Paga e anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil të jetë e barabartë me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

II. Paga e Kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil të jetë 10 për qind më e lartë se paga e anëtarit të këtij Komisioni.

III. Pagat e pozicioneve të punës për Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil të jenë sa pagat e pozicioneve ekuivalente në ministri.

IV. Vendimi i Kuvendit nr.459, datë 2.11.2000 “Për caktimin e pagave të anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil” shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

**DEKRET
Nr. 3332, datë 16.5.2002**

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Leonard Dhionis Cici
2. Adrian Aleks Kadiqi
3. Mileva Adrian Kadiqi
4. Chris Adrian Kadiqi
5. Katerina Kristo Kadiqi (Qendro)
6. Astrit Hazir Nezaj
7. Uendi Astrit Nezaj
8. Ricky Astrit Nezaj
9. Rajomonda Sadik Nezaj (Papdeja)
10. Kleopatra Pavli Dorner – Karajani
11. Flamur Ramadan Daullxhiu
12. Lumturie Xhemal Daullxhiu (Meno)
13. Leke (Lekë) Ndue Nikolli
14. Arjan Skënder Ibrahimaj
15. Entela Banush Wegener (Zylyfi)
16. Ismete Reshat Brosch (Sheme)
17. Spartak Neki Hoxha
18. Adriana Zija Rehmann (Jaho)
19. Përparim Fiqiri Murati
20. Gëzim Sadik Gjata
21. Skerdjano Ruzhdi Keraj
22. Manjola Fran Stanaj
23. Elona Nimet Stibor (Hoxha)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

DEKRET
Nr. 3339, datë 21.5.2002

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të kushtetutës, të nenit 20 dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Hil Marash Kabashi
2. Dodë Pashk Gjergji
2. Prelja Kolja Djurasaj (Djurašaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

VENDIM
Nr. 209, datë 16.5.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.602, DATË 17.11.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË DISA OBJEKTEVE
TË INDUSTRIËS SË BAKRIT DHE TË KROMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr.602, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:
"3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate."
2. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 210, datë 16.5.2002

PËR DHËNIE FOND NDIHME DISA PARTIVE TË REJA POLITIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Partisë të Gjelbrit e Shqipërisë, Partisë Aleanca Popullore Shqiptare, Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve dhe Partisë së Sigurimit Kombëtar t’u jepet, secilës, një fond ndihme prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2002 për partitë politike.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 211, datë 16.5.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.508, DATË 8.11.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË UZINËS SË
FERROKROMIT ELBASAN DHE MINIERAVE TË KROMIT PËRRENJAS DHE POJSKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr.508, datë 8.11.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrte.”.

2. Pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 212, datë 16.5.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.38, DATË 25.1.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË “SUPERFOSFATIT”
SH.A KURBIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr.38, datë 25.1.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate.”.

2. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 213, datë 16.5.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.82, DATË 26.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË MINIERËS SË
KROMIT BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË IMPIANTIT TË
SELEKSIONIMIT KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT, BURREL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7973 datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 82, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate.”.

2. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 219, datë 16.5.2002

PËR MBROJTJEN E RACËS AUTOKTONE TË BUAJVE NGA ZHDUKJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 7627, datë 21.10.1992 “Për shërbimin zooteknik” dhe të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Raca autoktone e buajve të shpallet racë “në gjendje kritike për t’u zhdukur”.
 2. Pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të ngrihet një komision vlerësimi për të bërë numërimin fizik të buajve dhe vlerësimin e gjendjes së tyre. Veprimtaria e këtij komisioni të rregullohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.
 3. Drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit, në bazë të aktit të vlerësimit, të lëshuar nga komisioni i vlerësimit, t’u paguajnë, për vitin 2002, me këste, dy herë në vit, fermerëve, pronarë të buajve, një pagesë vjetore prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për çdo riprodhuese femër dhe prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekësh për çdo riprodhues mashkull, të mbajtur për mbarështim.
 4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.
 5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 91, datë 13.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Tefta Zaka	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 27.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.232/5 Akti që i përket:

KËRKUES: GENCI MUHARREMI, përfaqësuar nga avokatët Vasil Dode e Kujtim Capo, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka pretenduar se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar:

- Vendimet e gjykatave kanë deklaruar fajësinë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, duke shkelur nenin 32/2 të Kushtetutës. Kështu, gjykata, ka lexuar thëniet e të dëmtuarit, të bëra gjatë hetimit, pa e pyetur atë në seancë gjyqësore;

- Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në Dhomën e Këshillimit, është në kundërshtim me Kushtetutën. Në rekursin drejtuar kësaj Gjykate, janë parashtruar shkaqe ligjore, gjë që investonte këtë Kolegj ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore. Procesi jo i rregullt ligjor qëndron në faktin se duke mos e shqyrtuar çështjen në një seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, kërkuesi i është mohuar e drejta e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Elbasanit, me vendimin nr.38, datë 18.4.2000, ka deklaruar fajtor kërkuesin Genci Muharremi për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, parashikuar prej neneve 76 e 22 të Kodit Penal dhe e ka dënuar me 7 vjet burgim.

Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.135, datë 26.6.2000, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Me vendimin nr.167, datë 27.2.2001, të marrë në Dhomën e Këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Genci Muharremi, si të pabazuar në ligj.

Në këto kushte, i mësipërmi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit Penal, duke pretenduar se ky vendim është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor.

Nga shqyrtimi i kësaj çështje në seancë gjyqësore, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shkeljet e pretenduara nga kërkuesi, si elementë të një procesi jo të rregullt ligjor, nuk rezultojnë të bazuara. Kështu, kërkuesi ka pretenduar se, në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës, gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre në të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Konkretisht, i mësipërmi ka parashtruar se gjykata e rrethit ka shkelur rregullat procedurale lidhur me leximin në seancën gjyqësore të thënieve të të dëmtuarit Danil Sadiku. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se Kodi i Procedurës Penale, në nenin 369, lejon leximin e akteve që përmbahen në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor, në rastet që parashikohen në këtë dispozitë. Nëse ka qenë ose jo rasti për leximin e thënieve është një çështje fakti dhe, në rastin në shqyrtim, gjykata e rrethit ka pranuar se plotësohen kushtet për aplikimin e kësaj dispozite.

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë nga ana e tij janë parashtruar shkaqe ligjore për prishjen e vendimeve dhe për këtë shkak, çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese vëren se është e vërtetë se në rekurs është parashtruar se vepra penale e kryer nuk duhej cilësuar si vrasje e mbetur në tentativë, por si plagosje e lehtë me dashje, duke analizuar se mungon ana subjektive e figurës së krimit të vrasjes. Por, Gjykata konstaton se nga pikëpamja e rrethanave të faktit, kërkuesi e pranon ngjarjen ndryshe nga gjykatat. Në këto kushte, ky pretendim, megjithëse në dukje jep përshtypjen e një pretendimi ligjor, në substancë është pretendim për prova dhe, duke qenë i tillë, nuk përbën element të një procesi të parregullt ligjor.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 92, datë 13.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Tefta Zaka	Anëtare e “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 28.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39 Akti që i përket:

KËRKUES: VASILIQI LEKA, përfaqësuar nga avokatët Dashamir Kore e Rahman Osmani, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: PAVLLO, MARIA E LIRI KISI, etj., përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.70, datë 28.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara, kërkuesi ka pretenduar se është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar:

- Kolegjet e Bashkuara kanë zhvilluar seancat gjyqësore në mungesë të kërkuetit, pa i dorëzuar atij kopjen e rekursit dhe pa i njoftuar datën e gjyqit. Gjykata e Rrethit Tiranë, ka adresuar një lajmërim-marrje në adresën e mëparshme të kërkuetit dhe jo në adresën ku banon që prej tre vjetësh. Mosmarrja e rekursit rezulton edhe nga shënimi që është bërë në lajmërim-marrje: “kthehet, adresë e pasaktë”.

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke bërë vlerësim provash, kanë ushtruar funksione të juridiksionit fillestar.

Ky është një veprim i kundërligjshëm dhe antikushtetues sepse kjo Gjykatë ka vetëm funksion rishikues të vendimeve të gjykatave më të ulëta, brenda kufijve të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo të drejtën të shqyrtojë nga pikëpamja e vlerësimit të provave themelin e çështjes.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuessit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.172, datë 22.1.1996, ka pranuar padinë, duke detyruar palën e paditur të njohë të drejtën trashëgimore të Petro Kisit mbi pasurinë e Marije Lekës dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të dëshmisë së trashëgimisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2767, datë 3.5.1996, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, rrëzimin e padisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1550, datë 30.6.1996, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e recursit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.70, datë 28.6.2001, kanë vendosur: “a) Prishjen e vendimeve nr.1550, datë 30.10.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.2767, datë 3.5.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; b) Lënien në fuqi të vendimit nr.172, datë 22.1.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë për pjesën që detyron të paditurit të njohin të drejtën trashëgimore të paditësve mbi pasurinë e Marije Lekës, si dhe rrëzimin e padisë e pushimin e gjykimit për pjesët e tjera”.

Me kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuessa Vasiliqi Leka ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i është shkëlur e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Si element të një procesi jo të rregullt ligjor kërkuessa ka parashtruar zhvillimin e gjykimit në mungesë të saj, pa iu dorëzuar një kopje e recursit dhe pa pasur dijeni për ditën e gjyqit.

Nga shqyrtimi i çështjes, Gjykata Kushtetuese, arrin në konkluzionin se pretendimi i kërkuesses është i bazuar.

Kështu, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Tiranë, me anë të një lajmërim-marrje, një kopje të recursit të paraqitur nga pala tjetër, ia ka adresuar kërkuesses Vasiliqi Leka, por ky lajmërim-marrje është kthyer sepse adresa ka qenë e pasaktë. Në këto rrethana, kërkuessa duke mos marrë recursin nuk ka ndjekur as shpalljet që afishon Gjykata e Lartë për të marrë njoftim për ditën e gjykimit dhe siç rezulton edhe nga dosja, gjykimi në Kolegjet e Bashkuara, është bërë në mungesë të saj. Është e vërtetë se në dosje ndodhet edhe një shpallje njëmuajore, por gjykata nuk duhet të procedonte me këtë mënyrë njoftimi, pa bërë ndonjë verifikim nëse ishte i mundur njoftimi sipas neneve 130-132 të Kodit të Procedurës Civile. Vetëm në rast se konkludohej se kjo gjë nuk mund të bëhej, atëherë mund të procedohej me njoftimin me shpallje, siç parashikohet në nenin 133 të këtij Kodi. Përveç kësaj, megjithëse shpallja mban datën 15.4.2001, nga përmbajtja e saj del sikur kjo shpallje të jetë nxjerrë për të njoftuar një ankim kundër një vendimi të gjykatës së apelit. Në këto kushte, përderisa në rastin në shqyrtim nuk janë respektuar rregullat procedurale për njoftimin e akteve, Gjykata konkludon se gjykimi në Kolegjet e Bashkuara në mungesë të kërkuesses, përbën shkelje të të drejtës së saj të mbrojtjes, e cila është një e drejtë themelore. Pikërisht kjo shkelje, e cila cenon një nga parimet bazë për një proces të rregullt ligjor, e bën antikushtetues vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për sa mësipër, kërkesa e paraqitur nga kërkuessa Vasiliqi Leka duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.70, datë 28.6.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 93, datë 13.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i	“	“
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Tefta Zaka	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 27.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti që i përket:

KËRKUES: XHAVIT ÇELIKU, etj., përfaqësuar nga avokatët Dilaver Rexhepi e Nexhdet Kambo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: XHELADIN E EQEREM QAZIMI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.2, datë 25.10.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.160, datë 27.2.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, kërkuesi ka parashtruar:

Të dyja gjykatat, në vendimet e tyre kanë konkluduar se çështja përbën gjë të gjykuar, duke lënë në fuqi një vendim që nuk i ka dhënë zgjidhje themelit. Në rastin në shqyrtim nuk ka gjë të gjykuar sepse gjykata është vënë në lëvizje me një padi të re, me objekt tjetër dhe palë të tjera.

Duke pranuar sa mësipër, megjithëse çështja nuk është zgjidhur në themel, gjykatat kanë hequr çdo mundësi për të rivënë në lëvizje gjykatën, duke i cenuar kështu të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuësve, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.4552, datë 28.12.1998, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të paditurit të njohin kërkuësin Xhavit Çeliku pronar mbi truallin.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2, datë 25.10.1999, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe rrëzimin e padisë si gjë e gjykuar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.160, datë 27.2.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këto kushte, kërkuësi Xhavit Çeliku, ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të fundit të Gjykatës së Apelit, si dhe të vendimit të Kolegjit Civil, duke pretenduar se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga nenit 42 i Kushtetutës. Sipas kërkuësit, duke pranuar se çështja përbën gjë të gjykuar, atij i është hequr mundësia për t'iu drejtuar për zgjidhjen e këtij konflikti.

Pretendimi i kërkuësit se, në rastin në shqyrtim, çështja përbën gjë të gjykuar i referohet vlerësimit të provave të bëra si nga gjykata e apelit, ashtu edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e, si i tillë, nuk mund të investojë Gjykatën Kushtetuese. Me këtë rast, Gjykata pohon edhe një herë qëndrimin e saj se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Sfera e kompetencave të kësaj Gjykate, në rastet kur shqyrton kërkesat e individëve, është e kufizuar. Në vështrim të nenit 131/f të Kushtetutës, ajo gjykon çështje të tilla, por vetëm në rastet e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Shkelje të tilla nuk kanë të bëjnë as me zbatimin e ligjit material e as me mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM (I SHKURTUAR)

Gjykata e Shkallës së Parë të Pogradecit, me vendimin nr. 334, datë 22.4.2002, shpalli të vdekur shtetasin Artan Shefqet Xhukellari.

KËRKESË

KËRKUESIT: Jolanda Lamaj (Hoxha), lindur më 1968 në Kraps, Fier dhe banuese në Sheq të Vogël.

OBJEKTI: Kërkoj shpalljen të vdekur të Kadrie Murat Hoxhaj, lindur në dhjetor 1943.

Jam vajza e Kadrie Hoxhaj.

Nëna ime figuron në gjendjen civile e gjallë, por në fakt ajo ka ndërruar jetë më 30 dhjetor të vitit 1977. Prandaj kërkoj të shpallet e vdekur.

KËRKUESE
Jolanda Lamaj

KËRKESË

KËRKUESE: Nafije Buciza, lindur në vitin 1963 dhe banuese në Arapaj, Durrës.

OBJEKTI: Shpalljen të vdekur të bashkëshortit tim Fejzulla Buciza.

I detyruar nga gjendja jo e mirë ekonomike bashkëshorti im emigroi me skaf në Itali në nëntor të vitit 1998, duke u nisur nga Durrësi. Gjatë rrugës skafi u mbyt. Duke qenë se ky fakt u publikua edhe nga media kërkoj që shtetasi Fejzulla Buciza të shpallet person i vdekur në bazë të të gjitha të dhënave që disponojmë.

KËRKUESE
Nafije Buciza

KËRKESË

KËRKUESE: Bajrame Piliçi, e bija e Hasanit dhe Fidaries, lindur më 1962 në Hudenisht, banuese në Podgorie Korçë.

OBJEKTI: Kërkoj të shpallet i zhdukur Algjerim Piliçi, i biri i Halilit dhe Xhemiles, lindur më 1961, banues në Podgorie.

Jam bashkëshortja e shtetasit Algjerim Piliçi. Bashkëshorti im është larguar në shtetin fqinj Greqi si emigrant në muajin nëntor 1999. Që nga ai moment nuk kemi marrë asnjë njoftim për vendndodhjen e tij. Prandaj kërkoj që të shpallet i zhdukur.

KËRKUESE
Bajrame Peliçi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 27.5.2002
Doli nga shtypi më 28.5.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë